# URDHËR
## Nr. 475, datë 20.7.2023

## PËR MIRATIMIN E FORMËS SË DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar dhe të nenit 28, pika 4 të ligjit nr 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

URDHËROJ

1. Miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
**Ulsi Manja**

## SHTOJCË NR. 1

## FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Dokumenti i identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm dhe është pronë e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Me sfond të bardhë, logon e drejtësisë në sfond dhe me shkronja të zeza. Fotografia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka përmasa 3cm x 2 cm.

## SHTOJCË NR. 1

FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Dokumenti i identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm dhe është pronë e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Me sfond të bardhë, logon e drejtësisë në sfond dhe me shkronja të zeza. Fotografia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka përmasa 3 cm × 2 cm.



MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Emër Mbiemër____________________
Përmbarues Gjyqesor Shteteror____
Zyra Përmbarimore __________

- Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Privat.
- Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesit gjyqësorë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë kërkohet ndihma e tyre.
- Ky dokument përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
Drejtor i Përgjithshëm
(Emer Mbiemër)______________________________